



Kontrolli I demtuesit.

Me kapjen e fluturave te para te mizes mesdhetare te agrumeve Te cilat fillojne dhe bien ne kurthe, qysh ne dhjete ditorin e pare te muajit Gusht dhe menjehere eshte organizuar puna per trajtimin e pare me preparatin Spinosad (1 meter katror ne kurore nga ana e lindjes).keto trajtime kane vazduar deri ne 30 tetor duke realizuar gjithsejt 5 sperkatje.Ndersa analiza e infeksionit aktiv ne kokerr rezultoi se mbas dates 20 tetor u kapen larvat e para, analize kjo e cila sherbeu si sinjal i fillimit te sperkatjes ne te gjithe kuroren me preparatin Lanat 0.2% (methomyl)

Merrni masa ne kohe per te parandaluar demin qe mund te shkaktoje miza meshdhetaree agrumeve.Mundi dhe djersa e gjithsecilit qe merret me kultivimin e agrumeve mund te shkoje dem ne rast se nuk vleresohet kontrolli I ketij demtuesi te rrezikshem.

Bashkepunoni me specialistet e bujqesise per te percaktuar momentin e duhur te nderhyrjes me trajtime.

Mos harroni se. te trajtosh ne momentin e duhur, kursen me shume leke, perfiton nje efikasitet te larte te trajtimit, ul ne menyre te ndjeshme dinamiken e popullates te demtuesit,siguron nje prodhim me sa me pak mbetje pesticidesh, mbron ambientin dhe biodivesitetin ne pergjithesi.

Kjo flet palosje u pergatit nga;
Agr. Mendim Bacaj. Specialist I mbrojtjes se bimeve
prane QTTB—Vlore
Cel 0682209469

Qendra e transferimit te teknologjive bujqesore-Vlore



Monitorimi dhe luftimi I mizes mesdhetare ne agrume.

(Ceratitis Capitata Wied)


QTTB-Vlore Tel. 033404145

E-mail qttpemtarivlore@yahoo.com

Miza mesdhetare e agrumeve

Miza e frutave ose miza e Mesdhetare (*Ceratitis capitata* (Wied.) (Diptera: Tephritidae) e ka origjinën nga brigjet e Afrikës Perëndimore, por me kalimin e kohës ka kolonizuar çdo kontinent (përveç Antarktidës), madje është gjetur në pothuajse të gjitha zonat tropikale, sub-tropikale. Kjo shpërndarje e gjerë është arritur në sajë të nivelit të lartë të përshtatshmërisë, potencial të lartë të saj riprodhues dhe njihet për polifaginë mjaft të shprehur (ushqehet me më shumë se 260 lloje të ndryshme pemësh, duke përfshirë edhe agrume, bërthanore... Thomas, 2005).

Këto karakteristika e kanë bërë atë një nga dëmtuesit më të dëmshëm që ndikojnë në agrikulturën në botë ku preken rreth 7.000.000 ha agrume dhe 1.400.000 ha fruta të tjera të ndjeshme ndaj *Ceratitis* (MAPA, 2009). Shkalla e saj është përkeqësuar edhe më tej në vitet e fundit për shkak të zgjerimit të kultivimit të varieteteve të agrumeve shumë të herëshme, sidomos Clementinë Marisol, e cila është jashtëzakonisht e ndjeshme, dhe që arrin pjekurinë e plotë gjatë periudhës së tetorit, kur ende hasen shpesh temperatura optimale që favorizojnë qëndrueshmërinë e mizës.



Demet që shkakton miza mesdhetare e agrumeve.

- Femra shpohet me ovopozitor një hapësirë të vogël në frut që shërben si portë hyrëse për insektet e tjera dhe për zhvillimin e kërpudhave, kalbëzimit etj... (Figura 3).



- Larva shkakton ulje të cilësive organoleptike dhe zvogëlim të tulit të frutit, e cila krijon shumë problem (kalbëzim) në frutat me madhësi të vogël. (mandarinat)
- Nxit rënien e parakohshme të frutave për shkak të infeksioneve shkaktuar nga metabolizmi sekondar i larvave.
- Edhe pse nuk arrihet dëmtim i plotë i frutit, fakti që në frut ka dëmtim, ka humbje vlerash tregëtare dhe mund të shkaktojë rënie të shitjes në treg të prodhimit.
Çdo dëmtim i tillë shkakton një përkeqësim në cilësinë e frutave, si dhe një kërcënim real për eksport dhe marketing, prandaj, marrja e masave në kohë për luftimin i këtij dëmtuesi është i detyruar dhe shumë efikas.

Monitorimi i dëmtuesit.

Për të bërë monitorimin e mizës mesdhetare të agrumeve aplikohet metoda e kapjes me kurthe specifike të shoqëruara me feromonet përkatëse të këtij dëmtuesi. Këto kurthe varen në pemë (mandarina) gjatë muajit Maj. Vendosen gjithsejt 4- 6 kurthe/Ha e kontrollohen një herë në javë për numërin e mizave të rëna. Të dhënat e marra shënohen në fletore nga ku do të gjykohej për të përcaktuar momentin e ndërhyrjes me trajtimet kimike. Një javë pas kapjes së mizave të para, jepet sinjali për fillimin e trajtimeve kimike.



